

NJOFTIM

Njoftohen të gjithë personat që do të aplikojnë për të marrë pjesë në provimet e aftësisë profesionale për **Ekspert Kontabël të Regjistruar** dhe **Kontabilist të Miratuar** se Autoriteti i Certifikimit ka miratuar:

1. Kalendari i provimeve sipas disiplinave është si më poshtë:

| | Disiplina | Data |
|-----------|---|------------------------|
| | | |
| 1. | Kontabilitet, raportim financiar dhe analiza e pasqyrave financiare | 28 prill 2012 |
| 2. | E drejta civile, e drejtë penale, legjislacioni tregtar dhe e drejtë e punës në Republikën e Shqipërisë, në masën që këto i nteresojnë auditimit ligjore të pasqyrave financiare | 19 maj 2012 |
| 3. | Kodi i etikës për profesionistët kontabël, standartet ndërkombëtare të kontrollit të cilësisë, standartet ndërkombëtare të auditimit, direktivat e praktikave ndërkombëtare të auditimit, standartet ndërkombëtare të angazhimeve për të rishikuar, standartet ndërkombëtare të angazhimeve të dhënies së sigurisë dhe standarde për çështje specifike, të publikuara nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve dhe të përkthyer, si dhe rregullat e organizimit të profesionit të ekspertit kontabël, të parashikuara në këtë ligj dhe në aktet në zbatim të tij | 4 qershor 2012 |
| 4. | Organizimi, drejtimi, administrimi dhe kontrolli i brendshëm i personave juridikë, përfshirë sistemet e informacionit dhe të informatikës | 18 qershor 2012 |
| 5. | Legjislacioni fiskal në Republikën e Shqipërisë | 27 qershor 2012 |

2. Periudha e pranimit të kërkesave për t'u regjistruar për të hyrë në provime do të jetë nga **data 19 mars – 6 prill 2012**. Kërkesat për regjistrim i drejtohen Autoritetit të Certifikimit përmes sekretariatit të tij, pranë organizatës profesionale të ekspertëve kontabël të regjistruar.

3. Lista e dokumentave që duhet të paraqesin kandidatët që dëshirojnë të regjistrohen për të marrë pjesë në testimin me shkrim të provimit të aftësisë profesionale për EKR dhe KM, kliko këtu...

4. Provimet do të zhvillohen në Fakultetin e Shkencave të Natyrës.

a) KANDIDATËT PËR EKSPERT KONTABËL TË REGJISTRUAR (EKR) duhet të paraqesin:

1. Kërkesën me shkrim drejtuar **Autoritetit të Certifikimit**, ku të listohen dokumentat e paraqitura,
2. Fotokopje të Kartës së identitetit,
3. Kopjë të noterizuar të certifikatës së stazhit profesional,
4. Kopje të noterizuar të diplomës së shkollës së lartë, të barazvlershme me diplomën universitare të nivelit të dytë ose diplomat e barazvlershme me to, për cdonjërin nga degët e studimit në shkencat ekonomike, si kontabilitet, financë, administrim biznesi, ekonomik apo të barazvlershme me to (Kur diploma është marrë në një shtet tjetër ajo duhet të jetë e njohur nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Shqipërisë,
5. Listën e notave të noterizuar,
6. Dëshmi të gjendjes personale gjyqësore.

b) KANDIDATËT PËR KONTABILIST TË MIRATUAR (KM) duhet të paraqesin:

1. Kërkesën me shkrim drejtuar **Autoritetit të Certifikimit**, ku të listohen dokumentat e paraqitura,
2. Fotokopje të Kartës së identitetit,
3. Kopje të noterizuar të diplomës së shkollës së lartë, të barazvlershme me diplomën universitare të nivelit të dytë ose diplomat e barazvlershme me to, për cdonjërin nga degët e studimit në shkencat ekonomike, si kontabilitet, financë, administrim biznesi, ekonomik apo të barazvlershme me to.
4. Listën e notave të noterizuar,
5. Vërtetim nga punëdhënësit ku të tregohet angazhimi prej të paktën tre vitesh pas përfundimit të shkollës së lartë, në fushën e kontabilitetit, financës, kontrollit financiar dhe në fusha të ngjashme,
6. Kopje të librezës së punës të noterizuar, të shoqëruar me vërtetim nga sigurimet shoqërore për gjendjen e sigurimit shoqëror e shëndetësor për të paktën minimumin e periudhës së angazhimit të përshkruar në pikën 5,
7. Vërtetime ose certifikata që tregojnë se kandidati ka kryer kursin e kualifikimit në fushën e standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit dhe raportimit financiar, të organizuar ose të monitoruar nga organizata profesionale e kontabilistëve të miratuar, apo edhe organizata të tjera të njohura,
8. Dëshmi të gjendjes personale gjyqësore.

Shënim: Kandidatët që kanë dorëzuar dokumentacion në sezonet e kaluar dhe nuk janë shpallur fitues për të marrë pjesë në provime në këtë sezon, duhet të paraqesin:

1. Nje Kërkesë të re me shkrim drejtuar **Autoritetit të Certifikimit**;
2. Dëshmi të gjendjes personale gjyqësore.

Do të regjistrohen vetëm ata kandidatë të cilët brenda afatit të përcaktuar, dorëzojnë të plotë dokumentacionin e kërkuar.